



Mësimi 2:

Llojet e Medias – Tradicionalja vs Digjitalja, Masive & Sociale

Koha për përgatitje: **30 minuta**

Kohëzgjatja e modulit: **1 x 60 minuta**

Abstrakt

Ky modul shqyrton evolucionin e medias nga platformat tradicionale te ato digjitale, duke analizuar veçoritë, rolet dhe ndikimin e tyre në komunikimin modern. Pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri mbi karakteristikat dalluese të medias tradicionale, përfshirë formatin e shtypur, transmetimet dhe formatet e jashtme (si posterët), si dhe mbi ngritjen e platformave të medias digjitale si faqet e internetit, blogjet, rrjetet sociale dhe shërbimet e transmetimit të videove.

Moduli thekson dallimet midis komunikimit njëdrejtimësh në median tradicionale dhe natyrës ndërvepruese të platformave digjitale, duke vënë në pah përfshirjen e audiencës, aksesin, personalizimin e përmbajtjes dhe besueshmërinë. Pjesëmarrësit do të kuptojnë gjithashtu sfidat që paraqet keqinformimi në hapësirat digjitale dhe rëndësinë e verifikimit të fakteve dhe vlerësimit kritik të burimeve të informacionit.

Burime edukative online

- **Moduli** mbi Mediat Tradicionale kundrejt Medias Digjitale, Masive dhe Sociale nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- **Kuici** mbi Mediat Tradicionale kundrejt Medias Digjitale, Masive dhe Sociale nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"

Fjalë kyçe

*Evolucioni i Medias,
Media Tradicionale,
Media Digjitale,
Media Sociale,
Ndërveprueshmëria*

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të zhvillojë kuptimin e pjesëmarrësve mbi evolucionin e medias, me fokus te dallimet dhe ndërlidhja mes platformave tradicionale dhe atyre digjitale. Ai synon të përmirësojë njohuritë për median duke nxitur mendimin kritik mbi besueshmërinë, aksesueshmërinë dhe ndërveprimin e llojeve të ndryshme të medias. Moduli gjithashtu synon të pajisë pjesëmarrësit me aftësi praktike për vlerësimin e burimeve të informacionit dhe për të promovuar konsum të përgjegjshëm mediatik.

Rezultati i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të njohë të rinjtë me rëndësinë e njohurive për lajmet në epokën digjitale. Ai vë në pah aftësinë për të analizuar në mënyrë kritike burimet e lajmeve dhe për të verifikuar saktësinë e informacionit. Synimi është të fuqizohen pjesëmarrësit që të marrin vendime të informuara dhe të kontribuojnë në një shoqëri më të vetëdijshme, duke reduktuar përhapjen e keqinformimit.

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–5: Hyrje

- Filloni me një pyetje : “Cilën platformë mediatike përdorni më shpesh dhe pse?”
- Përshkruani shkurtimisht qëllimin dhe rezultatet e pritshme të mësimit, duke theksuar rëndësinë e edukimit mediatik.

Min. 6–15: Prezantimi i përmbajtjes

- **Media Tradicionale:** Shpjegoni karakteristikat e medias së shtypur, transmetimeve (radio/TV) dhe medias së jashtme (p.sh. postera), duke u fokusuar te besueshmëria dhe natyra njëdrejtimëshe e komunikimit.
- **Media Digjitale:** Diskutoni rreth faqeve të internetit, blogjeve, rrjeteve sociale dhe shërbimeve të transmetimit (streaming), duke theksuar ndërveprueshmërinë dhe personalizimin e përmbajtjes.
- **Krahasim:** Përdorni një diagram Venn të thjeshtë ose një tabelë për të përmbledhur dallimet dhe ngjashmëritë.

Min. 16–30: Aktivitet ndërveprues

- Ndani pjesëmarrësit në çifte ose grupe të vogla.
- **Detyrë:** Analizoni pikat e forta dhe të dobëta të një shembulli të dhënë medieje (p.sh. një artikull në gazetë krahasuar me një postim në rrjete sociale).
- Grupet prezantojnë shkurtimisht përfundimet e tyre.

Min. 31–50: Diskutim dhe Zbatim Praktik

- **Diskutim:** Drejtoni një diskutim mbi besueshmërinë e medias dhe keqinformimin. Shtroni pyetje si: “Pse mendoni se keqinformimi përhapet më shpejt në platformat digjitale?”
- **Detyrë praktike:** Ofroni shembuj të përzier të artikujve të lajmeve të vërteta dhe të rreme. Në çifte, pjesëmarrësit identifikojnë informacionin e besueshëm duke përdorur teknika të verifikimit të fakteve.

Min. 51–60: Përfundime dhe Reflektime

- Përmbledhni pikat kryesore.
- Reflektoni mbi rëndësinë e edukimit mediatik.
- Caktoni një detyrë për në vazhdim: “Analizo zakonet e tua të konsumimit të medias gjatë javës që vjen dhe identifikoj një ndryshim që mund të bësh për t’i përmirësuar.”

Materiale/ Mjete

Projektor video; laptop/kompjuter desktop; lidhje interneti; qasje në Moodle; shembuj artikujsh lajmesh dhe skenarë për verifikimin e fakteve; fletë shpërndarëse ose lidhje digjitale për mjetet e verifikimit të fakteve; prezantim në PowerPoint ose Prezi i pasuruar me materiale vizuale (imazhe dhe klipe video).